

VENDIM
Nr. 22, datë 24.2.2012

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA, MARRËVESHJES SË
LIDHJES SË RE DHE FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR LIDHJE TË RE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “g” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës IV të Kodit të Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve, si dhe pikës 7.1.5 dhe 12 të Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifës së Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 79, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.2.2012, pasi shqyrtoi draftin e Rregullores së Lidhjeve të Reja, Marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularin e aplikimit për lidhje të re,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja”, marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularin e aplikimit për lidhje të re (aktet bashkëlidhur).
 2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit Drejtues të ERE-s nr. 17, datë 19.12.2001 “Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani